

FUNKSIONET, PAGAT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT
E PERSONELIT USHTARAK DHE CIVIL NË MINISTRINË E MBROTJES QË JANË SUBJEKT DEKLARIMI SIPAS LIGJIT

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Paga	Kompetencat dhe Detyrat
1	Znj. Anisa HOXHA	Drejtor Kabineti MM	II-1	Asiston drejtpërdrejtë ministrin e Mbrojtjes në hartimin e politikave dhe i përçon ato në Direktivën e Mbrojtjes, në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes dhe Sigurisë, në Strategjinë e Integruar të Burimeve Njerëzore të FA, Menaxhimin e Burimeve Materiale sipas prioritetve, Reformat Administrative dhe Ligjore, Politikat e Mbrojtjes dhe Sigurisë, Marrëdhëniet me jashtë (NATO, BE, vendet partnere). Monitoron përbushjen e reformave prioritare të ministrit të Mbrojtjes në fushën e Mbrojtjes. Orienton, organizon dhe harmonizon veprimtarinë në grup të Kabinetit të Ministrit. Është anëtare e Bordit Drejtues të Akademisë së Forcave të Armatosura.
2	Z. Tedi DERAJ	Këshilltar në Kabinetin e MM	II-1	Angazhohet në koordinimin e komunikimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, Reformën e edukimit dhe inovacionit, si dhe koordinimin e projekteve të ndryshme.
3	Znj. Sonila HYSI	Këshilltar në Kabinetin e MM	II-1	Asiston Ministrin e Mbrojtjes në të gjitha detyrat e tij, duke dhënë ndihmesën e tij për shqyrtimin, analizimin, monitorimin apo edhe hartimin e urdhrave, udhëzimeve, metodave të menaxhimit sa më efektiv të institucionit, tezave të ndryshme politike, si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga ministri i Mbrojtjes apo drejtori i Kabinetit.
4	Z. Blendi VATHI	Këshilltar në Kabinetin e MM	II-1	Këshilltar ligjor, mbulon punën lidhur me kontrollin dhe mbikëqyrjen e hartimit të projekt-akteve ligjore dhe nënligjore nga drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes si dhe në Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile.
5	Znj. Silvana SIMAKU	Këshilltar në Kabinetin e MM	II-1	Këshilltar pranë ministrit në fushën e zhvillimit të ardhshëm të industrisë ushtarake, problematikat dhe perspektivat e ndërmarrjeve shtetërore në varësi të ministrisë, si edhe në fushën e politikave me NATO dhe BE, prioritetet e bashkëpunimit, ndjekja e marrëveshjeve përkatëse dhe procesit vijues të hapjes së negociatave me BE.
6	Z. Kristaq GRABOCKA	Këshilltar në Kabinetin e MM	II-1	Asiston Ministrin e Mbrojtjes në të gjitha detyrat e tij, duke dhënë ndihmesën e tij për shqyrtimin, analizimin, monitorimin apo edhe hartimin e urdhrave, udhëzimeve, metodave të menaxhimit sa më efektiv të institucionit, tezave të ndryshme politike, si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga ministri i Mbrojtjes apo drejtori i Kabinetit.
7	Z. Albi ALLA	Këshilltar në Kabinetin e MM	II-1	Asiston Ministrin e Mbrojtjes në të gjitha detyrat e tij, duke dhënë ndihmesën e tij për marrëdhëniet me jashtë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.
8	Z. Aleks MARKU	Sekretar i Përgjithshëm	I-2	Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi civil i kategorisë më të lartë në Ministri, i cili mbikëqyr dhe përgjigjet direkt në lidhje me aktivitetin e të gjitha drejtorive në linjën e varësisë së tij, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre
9	Z. Gjergji METHOXHA	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Politikave të Mbrojtjes	I-4	Përgjigjet përpara Sekretarit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Mbrojtjes, për planifikimin, organizimin, drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë me qëllim zbrëthimin e orientimeve bazë politike në dokumente të qartë strategjike, afat-mesëm dhe afat-gjatë, ndjek dhe kontrollon zbatimin e tyre në praktikë dhe implementimin e orientimeve në marrëdhëniet e bashkëpunimit bilateral dhe shumëpalësh me vendet e NATO-s, BE-së.
10	Kol. Leonard KOLLÇAKU	Drejtor i Drejtorisë së Politikave NATO & BE	VKM nr.224, datë 21.03.2017, e ndryshuar (pagë për gradë)	Përgjigjet përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave të Politikave të Mbrojtjes për hartimin e politikave, programeve të zhvillimi në fushën e bashkëpunimit me vendet e NATO-s dhe BE. Jep mendime, rekomandime për vlerësimin e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes, marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe në aspektin strategjik dhe zhvillimet e tyre në vijimësi.
11	Z. Orges DAVIDHI	Drejtor i Drejtorisë së Modernizimit	II-2	Përgjigjet përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave të Politikave të Mbrojtjes për zndjekjen dhe zbatimin e prioritetëve të MM/SHPFA në lidhje me projektet e modernizimit të FA. Monitorimi i zbatimit të kontratave me subjekte të ndryshme për mjete, pajisje, mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi.
12	Z. Engjëll ÇAVO	Drejtor i Drejtorisë së Projekteve të Automatizimit dhe Inovacionit	II-2	Përgjigjet për ofrimin e ekspertizës në përgatitjen e draft-kontratave, zgjidhja e problemeve teknike që kanë të bëjnë me materializimin nga ana ligjore të projekteve strategjike, si dhe për çdo detyrim që rrjedh në zbatim të menaxhimit të kontratave.
13	Znj. Edlira ABAZI	Drejtor i Drejtorisë së Integritit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve	II-2	Përgjigjet përpara Drejtorit të Përgjithshëm të ministrisë për integrimin, monitorimin, kontrollin e implementimit, koordinimin e marrëveshjeve ndërkombëtare/memorandumeve të mirëkuptimit që lidhen në emër të RSH, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Mbrojtjes.
14	Z. Ylli IMERI	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse	I-4	Përgjigjet përpara Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë për ekzekutimin e kompetencave në mirëmenaxhimin e procesit të veprimtarisë ekonomike, prokurimit, pronave dhe aseteve, burimeve njerëzore, si dhe veprimtarisë mbështetëse të ministrisë.
15	Z. Nuri LAKNORI	Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar	II-2	Përgjigjet për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe optimizimin dhe shpërndarjen e burimeve të nevojshme financiare. Garanton planifikimin, optimizimin dhe mirëmenaxhimin e burimeve financiare, me qëllim që të garantohet realizimi i misionit, ekzekutimi i funksioneve dhe arritja e objektivave të sistemit ministror dhe Forcave të Armatosura.
16	Znj. Dafina KEÇA	Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve dhe Ankadeve	II-2	Përgjigjet për prokurimet publike, ushtarake dhe të klasifikuara si dhe procesin e shitjes së vlerave (mallrave) materiale të dala jashtë përdorimit me ankand publik. Garanton, organizimin, realizimin, administrimin e procedurave të prokurimeve publike, ushtarake dhe të klasifikuara, si dhe procesin e shitjes së vlerave (mallrave) materiale të dala jashtë përdorimit me ankand publik
17	Kol. Artan AJAZI	Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve	VKM nr.224, datë 21.03.2017, e ndryshuar (pagë për gradë)	Përgjigjet përpara Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në lidhje me hartimin e politikave, rregulloreve, urdhrave dhe udhëzimeve në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, arsimimit, përkujdesjes sociale të personelit.
18	Kol. Arjan HILAJ	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm	VKM nr.224, datë 21.03.2017, e ndryshuar (pagë për gradë)	Përgjigjet për inspektimet, kontrollat dhe verifikimet e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, direktivave në Ministrinë e Mbrojtjes, SHPFA dhe strukturave të vartësisë. Trajton kërkesat dhe ankesat drejtuar Ministrit të Mbrojtjes, udhëheq inspektimet dhe kontrollat në strukturat e FA. raporton periodikisht tek Ministri i Mbrojtjes.
19	Z. Edmond GORE	Drejtor i Drejtorisë së Auditimit	II-2	Përgjigjet për ushtrimin e misionit të auditimit, menaxhimit të performancës në institucionet e varësisë në drejtim të funksionimit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar si dhe jep këshilla për përmirësimin e funksionimit dhe shtimin e vlerave. Dhënia e sigurisë objektive dhe të pavarur si dhe e shërbimeve të konsulencës për veprimtarinë dhe performancën e institucionit.